



Java Kundër
KORRUPSIONIT
3-9 DHJETOR 2017

PROKURORIA, "AMNISTIMI I VETVETES"



REPUBLIKA E KOSOVES
PROKURORI I SHTETIT

#bashkeendreqim #UnitedAgainstCorruption #KS

Koalicioni i OJQ-ve "Java Kundër Korrupsionit 2017" përbëhet nga:
IKD, GLPS, ÇOHU, GAP, INPO, KIPRED dhe COLUMBUS



Autor: Instituti Columbus

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.



Ky projekt është mbështetur përmes grantit nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara, Prishtinë. Mendimet, të gjeturat dhe konkluzionet apo rekomandimet e shprehura janë të autorit dhe domosdoshmërisht nuk reflektojnë ato të Departamentit të Shtetit.

Rreth Institutit Columbus

Instituti është themeluar si organizatë e pavarur, joqeveritare, joprofitabile, me vullnet të mirë dhe ka si qëllim promovimin e filozofisë politike dhe shoqërore të lirisë, demokracisë dhe barazisë në Kosovë.

Adresa: Nëna Terezë 31b; Tel: +381 (0) 38 243 875 ; +377 (0) 44 555 404;

E-mail: info@instituticolumbus-ks.com

Dhjetor 2017

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

I.	Përmbledhje ekzekutive	3
II.	Përshkrim i rastit	4
III.	Gjetjet konkrete	5
IV.	Pyetjet publike	5

I. Përmbledhje ekzekutive

Niveli i lartë i korrupsionit ka hedhur dyshime se një shumë e madhe e parasë publike keqpërdoret nëpërmjet prokurimit publik. Sipas statistikave, rreth 700 milionë euro në vit të buxhetit të Kosovës shpenzohen përmes prokurimit publik, fushë kjo e cila për vite me radhë në raportet vendore dhe ndërkombëtare, është konsideruar si burim i korrupsionit.

Institucioni që vazhdimisht e heton këtë rast është Prokuroria e Shtetit. Ani pse një pjesë e madhe e aktakuzave që ngrit ky institucion dështojnë në gjykatë, në praktikë nuk kontestohet keqpërdorimi me tender. Një gjë të tillë e ka bërë edhe vet Prokuroria e Shtetit.

Prokuroria, në kundërshtim me ligjin, ka ftuar kompaninë “Translation Center” për të përkthyer shkresat e një prej lëndëve më të mëdha të korrupsionit në vend, duke përjashtuar përkthyesit e tjerë. Behët fjalë për dosjen e shkresave të rastit të njohur si “Stenta”. Këtë e kanë bërë, siç kanë thënë ata, pasi lënda ka përmbajtur “informata konfidenciale”. Por siç e kanë faktuar mediat, vetëm shtatë faqe kanë qenë konfidenciale, ndërsa tenderi është dhënë për mijëra faqe.¹ Një precedent i tillë në organin hetues, duke shkelur Ligjin e Prokurimit Publik, mbi bazën e të cilit edhe është ngritur aktakuza “stenta”, ka vënë në dyshim integritetin dhe seriozitetin e ndjekjeve të shkeljeve në prokurim. Prokuroria e Shtetit nuk ka hapur fare hetim për këtë rast, ani pse Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, pas kërkesës se Prokurorisë, ka evidentuar shkeljen e ligjit. Asnjë masë për askënd në këtë institucion nuk është iniciuar. Në kundërshtim me ligjin, e kanë ftuar një kompani dhe kanë përjashtuar përkthyesit e tjerë. Këtë e kanë bërë, siç kanë thënë ata, pasi lënda ka përmbajtur “informata konfidenciale”. Por vetëm 7 faqe nga e gjithë dosja mbi 10 mijë faqe janë të klasifikuara si dokumente konfidenciale.

Prokurimi publik në Kosovë për vite me radhë në raportet vendore dhe ndërkombëtare ishte konsideruar si burim i korrupsionit në vend. Një vlerësim i tillë ishte dhënë vazhdimisht në raportet e progresit për Kosovën të Komisionit Evropian.

Ndryshe, qëllimi i Ligjit për Prokurim Publik është që të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike dhe burimeve publike në Kosovë, duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen.

¹<http://www.koha.net/video/37507/per-perkthimin-e-dosjes-stenta-prokuroria-jep-35-mije-euro-pa-tender/>

II. Përshkrim i rastit

Prokuroria e Shtetit e ka akuzuar para dy vjetësh ish-ministrin e Shëndetësisë, Ferid Agani, se kishte kontraktuar vendosjen e stentave në dy spitale private, duke e shpërfillur Ligjin e Prokurimit Publik.

Për këtë çështje, interpretim kishin kërkuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, sipas të cilave, Agani e kishte shkelur ligjin kur kishte vendosur që të ndajë para pa procedurë të prokurimit.

Mbi këtë bazë, Agani është njëri prej të akuzuarve në rastin “Stenta”.

Prokuroria e Shtetit, përmes Këshillit Prokurorial, e ka bërë shkeljen e njëjtë sikurse Agani. E kanë përkthyer dosjen e hetimeve “stenta” pa hapur fare tender. Pas përkthimit, janë konsultuar me KRPP-në, e cila ka vlerësuar se është shkelur ligji kur PSH-ja ka shmangur procesin tenderues nëse materiali nuk ka qenë i ndjeshëm dhe se ndjeshmëria e materialit duhet të përcaktohet para se të shmangën procedurat e tenderit. Përderisa për rastin e kontraktimit të spitaleve pa tender, Agani e ka humbur pozitën e ministrit dhe shkelja e tij ka arritur në gjykatë, rastin kur vetë Prokuroria e Shtetit e ka bërë shkeljen e njëjtë me Aganin, po e konsiderojnë “anomali ligji”.

Një shkelje e tillë është evidentuar edhe nga institucione të tjera.

Zyra Kombëtare e Auditorit, e cila është kompetente për të gjetur shkeljet në shpenzimin e parasë publike, e ka fshehur një keqpërdorim financiar në Prokurorinë e Shtetit. Tri shkelje i ka gjetur ZKA-ja në tenderin e përkthimit të dosjes “Stenta”. Ky përkthim, sipas ZKA-së, është bërë pa tender, nga një kompani që nuk figuron e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Biznesit dhe shërbimet i ka përfunduar pas skadimit të kontratës.

Këto gjetje kanë qenë të evidentuara në draft-raportin e parë të ZKA-së, por ato janë larguar në raportin final².

²<http://www.koha.net/arberi/38181/auditori-fsheh-keqperdorimin-financiar-te-prokurorise/>

III. Gjetjet konkrete

- Prokuroria e Shtetit nuk ka hapur tender për përkthimin e dosjes “Stenta”. Një gjë e tillë është e jashtëligjshme. Përjashtimet e blerjeve të shërbimeve nga ky ligj mund t’i bëjë vetëm institucioni i specializuar, që në këtë rast nuk është Prokuroria e Shtetit. Pavarësisht nga dispozitat tjera të këtij ligji, autoriteti kontraktues nuk mund të mos respektojë dispozitat e këtij ligji mbi transparencën gjer në shkallën kur përputhshmëria dhe respektimi do të kompromitonin sekretin e ligjshëm ose interesat e sigurisë gjatë kryerjes së aktiviteteve të prokurimit, të rëndësishme për dhënien e një kontrate publike, për të cilën qeveria është pajtuar që ta përjashtojë nga fushëveprimi i këtij ligji.³
- Prokuroria e Shtetit vazhdimisht ka ngritur aktakuza për vepra të ngjashme penale. Në mesin e tyre është edhe aktakuza për rastin “Stenta”. Ish-ministri Ferid Agani është akuzuar pikërisht për shkak të shmangies së procedurave të prokurimit. Ky institucion, ditë me parë, ka ngritur aktakuzë edhe për një tjetër parregullsi në tender. Sipas aktakuzës, i akuzuari I.B., në periudhën kohore gusht 2015 deri në dhjetor të vitit 2016, në cilësinë e drejtorit të Administratës Publike pranë Komunës së Prizrenit, duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar, i ka tejkaluar kompetencat e tij zyrtare, duke keqpërdorur pasurinë publike, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për persona tjerë juridikë, në atë mënyrë që pa ndonjë procedurë të tenderimit, ka lidhur kontrata për emetimin e spoteve reklamuese në lidhje me aplikimet online për nevojat e Komunës së Prizrenit, gjegjësisht të Drejtorisë së Administratës Publike, ku janë paguar shuma të hollave prej 37.450,00 euro, 25.650,00 euro dhe shuma prej 9.800,00 euro.⁴
- Zyra Kombëtare e Auditimit e ka fshehur një shkelje të tillë të Prokurorisë së Shtetit. Kjo ngrit dyshime se të gjeturat e ZKA-së para publikimit filtrohen në atë mënyrë që disa institucioneve publike t’u fshihen veprimet, të cilat dyshohet se janë inkriminuese.
- Prokuroria e Shtetit ka refuzuar të hetojë këtë rast. Një gjë e tillë e kanë bërë duke arsyetuar se Ligji i Prokurimit Publik nuk rregullon në mënyrë të saktë prokurimin e këtij institucioni. Shkeljet e këtij ligji, për të cilin ngritin aktakuza, në rastin e tyre i kanë quajtur “shkelje administrative”.

IV. Pyetjet publike

Pse nuk është hetuar ky rast nga Prokuroria e Shtetit?

Si është i rregulluar prokurimi për materiale të tilla dhe pse PSH-ja nuk e respektoi ligjin?

³<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>

⁴<http://www.psh-ks.net/>

Cili është dallimi i shkeljeve të Ligjit të Prokurimit nga institucionet tjera publike me shkeljet që ia bën PSH-ja?

A e kuptojnë prokurorët Ligjin e Prokurimit?

A është i domosdoshëm specializimi dhe trajnimi i tyre në këtë fushë?